



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga gazetari i TV Euronews Albania

Znj. Elona Gjylmi

Email- lona\_gjylmi@yahoo.com

**TIRANË**

E nderuar znj. Gjylmi,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr 1282 (tonën) prot. datë 27.07.2022, lidhur me vënien në dispozicion të vendimeve për pastërti figure për personat e përmendur në njoftimin zyrtar të datës 26.07.2022, për shtetasit A.D. Th.S. S.H. Xh.Sh. D.Ç. dhe I.M., e paraqitur pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), Ju informojmë si më poshtë:

Referuar dispozitës të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar parashikohet “Autoriteti nuk administron kërkesat për informacion për zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, kur Autoriteti administron apo i janë vënë në dispozicion dokumenti autentik origjinal i certifikatës së pastërtisë së figurës, shoqëruar me vendimin përkatës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar.

Sa më sipër subjektet e përmendur në njoftimin zyrtar gëzojnë mbrojtjen ligjore të dispozitave të ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar. Ligji nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, në nenin 16 të tij parashikon se “Në mungesë të dispozitave të tjera ligjore ***ndalohet marrja kontakt me dokumentacionin objekt i këtij ligji për vendime që lidhen me personat pas vitit 2001 e deri në vitin 2025.***

Dispozita e ligjit nr. 8043/1995, - neni 16 “Në mungesë të dispozitave të tjera ligjore ***ndalohet marrja kontakt me dokumentacionin objekt i këtij ligji për vendime që lidhen me personat pas vitit 2001 e deri në vitin 2025.*** – thekson mbrojtjen që ligjvënësi i ka dhënë fondit të arkivit të krijuar gjatë periudhës së cilës ka funksionuar Komisioni Shtetëror deri në vitin 2025. (aktet bëjnë pjesë në një fond i cili ka nivele klasifikimi sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk është i hapur për çdo subjekt kërkues).

Neni 11 i ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” parashikonte gjithashtu se ”Ndalohet tu bëhen të njohura opinionit publik faktet e parashtruara në vendimin e komisionit, si dhe vetë vendimi pa pëlqimin paraprak me shkrim të personit të interesuar me përjashtim të rastit të përmendur në nenin 9 paragrafi i parë”.

Ligjvënësi i kohës, i ka dhënë të drejtë Komisionit Shtetëror që për secilin emër dhe mbiemër (subjekt) të zbatojë parashikimet e ligjit duke bashkëpunuar me secilin institucion në Republikën e Shqipërisë para daljes me vendim duke ndaluar bërjen publike të fakteve të grumbulluara pasi përmbajnë të dhëna personale të personave për të cilat ligji kërkonte pëlqimin paraprak të subjekteve.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” në fushën e së drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, konkretisht ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dokumentacioni që disponon Autoriteti, përkatësisht kërkesa institucionale (së bashku me formularin e aplikimit të plotësuar nga kandidatët) dhe rrjedhimisht vendimi që del nga Autoriteti për subjektin e verifikimit, përmbajnë të dhëna personale të subjektit, personave të tjerë, të cilat gëzojnë ruajtje sipas legjislacionit në fuqi dhe për këtë arsye nuk mund t’i vendosen asnjë pale tjetër në dispozicion me përjashtim të institucioneve të përcaktuara nga ligji.

Në kuadër të bashkëpunimit midis institucioneve, Autoriteti ka paraqitur edhe Vendimin nr. 321 datë 26.07.2022 për miratimin e propozimeve të ndryshimeve ligjore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**Drejtori i Informacionit**

**Selami Zalli**

Konceptoi: L. Cocoli  
Datë: 27.07.2022